



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.403, datë 30.07.2024

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR.235 DHE NR.236, DATË 02.05.2024, TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 30.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}”, për gatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.233- nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 16.05.2024 dhe data 30.05.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024 kandidoi edhe z. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 235/2024 dhe 236/2024 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

5. Me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”, Këshilli ka vendosur:

“3.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Tiranë, dhe Fier të shpallura me vendimet nr. 234, 235, 236, 237, 238, 239, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim..

4. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...2. Për kandidatin z {...} - relator z. Klodian Kurushi;...”

5. Më datë 07.06.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

8. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të postës elektronike të datë 07.06.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

9. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile dhe penale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, informacioni i kërkuar është përcjell nëpërmjet postës elektronike siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

11. Për kandidaten z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 235/2024 dhe 236/2024 është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

13. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysht se ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236 datë 02.05.2024 çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

14. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019 dhe ushtron detyrën në Gjykatën së rrethit gjyqësor Dibër. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Dibër, në datë 25.10.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht.

15. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} , ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 05.10.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca Penale pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 12, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 56, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Me vendim nr. 129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në datë 25.10.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

16. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se; *“Nga data 29.01.2020, ka filluar detyrën si gjyqtar pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku aktualisht ushtron edhe detyrën e zv/kryetarit të Gjykatës. Gjithashtu z. {...} ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht çështje penale, civile, familjare dhe tregtare, pasi Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta penale dhe civile.”*

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

18. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

19. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit 235/2024 dhe 236/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*

20. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 15.05.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

21. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

22. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

23. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

24. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 235/2024 dhe 236/2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

25. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 15.05.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

26. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin Këshilli vlerëson se z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke plotësuar kështu kriterin e “*papajtueshmërisë ambientale*”.

III. KONKLUSIONE

28. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr.235 dhe nr.236 datë 02.05.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236 datë 02.05.2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 235, datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”; nr. 236, datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;

V E N D O S I :

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR